



VENDIM

Nr. 98 Date 27.10.2014

**PER PËRFUNDIMIN E ADMINISTRIMIT TE PËRKOHSHËM TE
SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TE SHPËRNDARJES SE
ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A (OSHEE)**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 18, pika 5, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimeve të Bordit të Komisionereve nr. 96 date 27.10.2014 si dhe nr. 97 date 27.10.2014, për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice, të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014,

Konstatohet se:

- Në bazë të Vendimit nr.5 date 21.01.2013, aktiviteti i Shpërndarjes dhe ai i Furnizuesit Publik me Pakice të Energjisë Elektrike kryehet aktualisht nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE) në administrim të përkohshëm
- Me vendimet nr.96 date 27.10.2014 si dhe nr. 97 date 27.10.2014, Bordi i Komisionereve vendosi licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice, të energjisë elektrike,

Për gjithë sa me sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI :

1. Përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE), sipas Vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.5, date 21.01.2013.
2. Shfuqizimin e akteve nënligjore të mara në zbatim të Vendimit nr.5, date 21.01.2013.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje aplikuesin, Ministrine e Energjise dhe Industrise si dhe Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Siper marrjes per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 98 Date 27.10.2014

**PER PËRFUNDIMIN E ADMINISTRIMIT TE PËRKOHSHËM TE
SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TE SHPËRNDARJES SE
ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A (OSHEE)**

Anetaret e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____